

**URDHËR**  
**Nr. 5, datë 3.1.2024**

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

**URDHËROJ**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Endrit Musaj, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2024.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Ardit Bido**